



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me datë **02.06.2025** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes nr. 214/1, të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurve **Evis Berberi, Valter Begaj, Ervis Lami, Brunilda Buli, Gentian Gjyli, Genti Raça, Erald Elezi, Artan Leskoviku, Altin Marko, Orjon Islamaj, Adrian Kroj, Bledar Aliaj, Blerta Musabelli, Kamelia Tafaj, Adela Kica, Denis Xhoxhi, Adja Strazimiri, Gëzim Noni, Shkëlqim Lusha, Ela Goxhaj, Jetmira Dervishi, Vabona Pepa, Person Juridik “Net Group” shpk, Personi juridik “DAAM” shpk**”.

2. Në seancën e datës **09.12.2025** (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Bib Ndreca, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, bazuar në nenet 332-332/gj dhe 379/2 të K.Pr.Penale, me vendimin nr. **106**, datë **09.12.2025**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. **214/1, të vitit 2023**, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të të pandehurve, **Evis Berberi, Valter Begaj, Ervis Lami, Brunilda Buli, Gentian Gjyli, Genti Raça, Erald Elezi, Artan Leskoviku, Altin Marko, Orjon Islamaj, Adrian Kroj, Bledar Aliaj, Blerta Musabelli, Kamelia Tafaj, Adela Kica, Denis Xhoxhi, Adja Strazimiri, Gëzim Noni, Shkëlqim Lusha, Ela Goxhaj, Jetmira Dervishi, Valbona Pepa, Person Juridik “Net Group” shpk, Personi juridik “DAAM” shpk**.
3. Kjo çështje i dërgohet trupit gjykues të themelit prej tre anëtarësh në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si gjykatë kompetente për gjykimin e saj.
4. Së bashku me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin e çështjes në gjyq, dërgohen edhe kërkesat e të pandehurve: **1.Evis Berberi, 2.Ervis Lami, 3.Brunilda Buli, 4.Gentian Gjyli, 5.Genti Raça, 6.Erald Elezi, 7.Artan Leskoviku, 8.Altin Marko, 9.Orjon Islamaj, 10.Adrian Kroj, 11.Bledar Aliaj, 12.Blerta Musabelli, 13.Kamelia Tafaj, 14.Adela Kica, 15.Denis Xhoxhi, 16.Ajda Stazimiri, 17.Gëzim Noni, 18.Shkëlqim Lusha, 19.Ela Goxhaj, 20.Jetmira Dervishi, 21.Valbona Pepa**, për gjykim të shkurtuar.

5. Fashikulli i gjykit përmban të gjitha aktet e kryera gjatë hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 214/1, të vitit 2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe ato të marra në seancë paraprake, të paraqitura nga palët dhe të administruara nga gjykata.
6. Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq ligji nuk lejon ankim, kjo sipas parashikimeve të nenit 332/gj pika 1 të K.Pr.Penale.

Tiranë, më datë 09.12.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar